REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALUSHNJE

Nr. 6023 Prot.

Lushnje, më 15 / 07 /2025

RELACION
PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK
"PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR "ENFORSA – FORCIMI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE PARANDALIMIT TË ZJARREVE PËRMES TEKNOLOGJIVE TË AVANCUARA DHE MASAVE TË ZBATUARA NË ZONAT NDËRKUFITARE"

Bashkia Lushnjë është përfshirë si partnere në projektin ndërkombëtar "ENFORSA – Forcimi i menaxhimit të pyjeve dhe parandalimit të zjarreve përmes teknologjive të avancuara dhe masave të zbatuara në zonat ndërkufitare, mbështetur nga Programi Interreg VI-A IPA Greqi-Shqipëri 2021–2027 me **kohëzgjatje:** 01.09.2025 – 01.09.2027 (24 muaj) dhe partnerë:

- Instituti i Kërkimeve Pyjore (ELGO-DIMITRA, Greqi) – Partner udhëheqës
- Bashkia Lushnje – Partner zbatues në territorin shqiptar

Qëllimi i projektit:

Projekti synon të:

- Parandalojë dhe menaxhojë rreziqet klimatike, veçanërisht zjarret në pyje
- Fuqizojë kapacitetet vendore për përballimin e emergjencave
- Zbatojë Planin e Emergjencave Civile të Bashkisë Lushnje përmes teknologjive të reja

Aktivitetet kryesore

1. **Teknologji për hartëzim dhe parandalim (GIS)**
   - Hartëzim i zonave me rrezik përmes GIS
   - Planifikim i masave parandaluese
2. **Pajisje dhe masa praktike për mbrojtje nga zjarret**
   - Automjete dhe pajisje për ndërhyrje të shpejtë në terren
   - Modernizim i kapaciteteve të Bashkisë Lushnje
3. **Ndërgjegjësim dhe përfshirje komunitare**
   - Aplikacion mobil për qytetarët
   - Fushata sensibilizuese dhe trajnime për personelin

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Buxheti i projektit

- **Totali i projektit:** 777,500 €
- **Bashkia Lushnje:** 400,249 €
  - 80% financim nga Bashkimi Europian
  - 20% bashkëfinancim kombëtar (nga SASPAC)

Përmbledhje e buxhetit sipas zërave kryesorë për Bashkinë Lushnje:

- Pajisje dhe mjete për mbrojtje civile: **~245,000 €**
- Shërbime për hartëzim dhe platforma GIS: **~63,000 €**
- Trajnime, fushata informimi dhe aplikacion mobil: **~52,000 €**
- Menaxhim dhe administrim projekti: **~40,000 €**

Rezultatet e pritshme

- Hartë dixhitale për monitorimin e zjarreve
- Përmirësim i Planit të Emergjencave Civile
- Aplikacion mobil për qytetarët
- Rritje e kapaciteteve teknike dhe operacionale të Bashkisë
- Angazhim i komunitetit në parandalimin e rreziqeve

Qëndrueshmëria

- Pajisjet do të jenë pronë e Bashkisë
- Plani i emergjencave do të përditësohet rregullisht
- GIS dhe aplikacioni do të mirëmbahen nga Njësia e Mbrojtjes Civile
- Synohet sigurimi i fondeve të tjera për zgjerim dhe mirëmbajtje

Vlera e shtuar për Bashkinë Lushnje:

- Mbrojtje më e mirë e pyjeve dhe tokave bujqësore
- Siguri më e lartë për qytetarët dhe zonat rurale
- Bashkëpunim me institucione shkencore greke
- Qëndrueshmëri më e madhe përballë krizave klimatike

DREJTORIA E PËRGJITHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT

Ariola Korreshi

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr. 6023 **Prot.** **Lushnje, më** 15 / 07 **/2025**

PROJEKT - VENDIM

NR. 71 **Datë** 15/07/2025

"PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR "ENFORSA – FORCIMI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE PARANDALIMIT TË ZJARREVE PËRMES TEKNOLOGJIVE TË AVANCUARA DHE MASAVE TË ZBATUARA NË ZONAT NDËRKUFITARE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __/__/__ pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit "Për Regjistrimin e Projektit Ndërkombëtar "ENFORSA – Forcimi i menaxhimit të pyjeve dhe parandalimit të zjarreve përmes teknologjive të avancuara dhe masave të zbatuara në zonat ndërkufitare", në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 neni 54 gërma n "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 neni 6, neni 15 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr.68/2017 neni 6 gërma a, neni 10 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligji Nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjin Nr. 43/2016 "Për marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 775 pika 5, pika 13, pika 21 datë 24.09.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja", Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 10, datë 12.07.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozim të Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak Lushnje,

PROPOZOJMË:

1. Të ardhurat e Bashkisë për vititn 2025-2027 të shtohen në vlerën **400,249** Euro (**39,272,431.88** ALL) **"ENFORSA – Forcimi i menaxhimit të pyjeve dhe parandalimit të zjarreve përmes teknologjive të avancuara dhe masave të zbatuara në zonat ndërkufitare"**.
2. Buxheti i ndarë sipas kategorive (01 Shtator 2025 – 01 Shtator 2027) është i detajuar:

   - Pajisje dhe mjete për mbrojtje civile: **245,000 €**
   - Shërbime për hartëzim dhe platforma GIS: **63,000 €**

- Trajnime, fushata informimi dhe aplikacion mobil: **52,000 €**
- Menaxhim dhe administrim projekti: **40,000 €**

(Kursi i këmbimit për llogaritjen e vlerës në ALL bazohet në Udhëzimin 66/2006 "Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të Lekut në Bankën e Shqipërisë" përditësimi i fundit: 15/07/2025)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit dhe Drejtoria e Buxhet-Financë
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit,
Politikave Sociale dhe Informimit
Ariola Korreshi

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE